



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENER GjISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 303, Datë 23.10.2023

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “IDI 2005” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENER GjISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK  
“TEKSOEN 1”

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, gërma “a”, 38, pika 1, gërma “a” dhe 39, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14, pika 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2033/18 prot., datë 18.10.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Teksoen 1”, me kapacitet të instaluar 2 MW”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2033 prot., datë 16.08.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Teksoen 1”, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në njësinë Administrative Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier dhe bordi i ERE-s, me vendimin nr. 255, datë 23.08.2023 vendosi të fillojë procedurën e licencimit për shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Teksoen 1”, me kapacitet të instaluar 2 MW.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 24.08.2023 dhe 25.08.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 02.09.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Me shkresat nr. 2033/3 prot., dhe nr. 2033/4 prot., datë 12.09.2023, ERE i njoftoi shoqërisë fillimin e procedurës dhe i evidentoi dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim, ndërsa me shkresën nr. 2102 prot., datë 04.09.2023, ERE i është drejtuar edhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) duke i njoftuar fillimin e kësaj procedure.

- Shoqëria me shkresat nr. 2033/5 prot., datë 12.09.2023 dhe nr. 2033/6 prot., datë 15.09.2023 depozitoi dokumentacion plotësues, i cili rezultoi jo i plotë për këtë aplikim. ERE me vendimin e bordit nr. 282, datë 25.09.2023, vendosi të zgjasë deri në 30 ditë afatin e vendimmarrjes përfundimtare në lidhje me aplikimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k.
- ERE me shkresën nr. 2033/13 prot., datë 03.10.2023, njoftoi shoqërinë për zgjatjen e vendimmarrjes mbi aplikimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Teksoen 1” me kapacitet të instaluar 2 MW.
- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2033/17 prot., datë 17.10.2023, përcolli në ERE dokumentacion plotësues të aplikimit.
- Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Ankesit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Aplikuesi ka depozituar në ERE, Kontratën me nr. 2306 rep, nr. 1235 kol., datë 25.05.2023, “Kontratë për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2MW, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale nr. 3038, njësia Administrative Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “IDI 2005” shpk, nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim, shoqërisë “IDI 2005” shpk”.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c”; dhe pikën 2.1, gërmat “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Aplikuesi ka depozituar në ERE VNM Paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr. AN300920220011, datë 26.10.2022, Komisioni 80, kjo VNM konsiderohet e vlefshme, por duke qenë se shoqëria nuk ka filluar punimet e ndërtimit, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë të informojë ERE-n çdo 3 (tre) muaj në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, por jo më vonë se data 26.10.2024, datë e cila përfundon dhe vlefshmëria e kësaj VNM-je.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Teksoen 1” me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 30 vjeçar.
2. Shoqëria të informojë ERE-n çdo 3 (tre) muaj në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltaik, por jo më vonë se data 26.10.2024.

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të informacionit sipas përcaktimeve të pikës 2, në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së Paraprake.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**